

Përsëritje e nderuari z. Arbër Halilaj,

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të ankesës suaj, ju njofton se në kuadër të zhvillimit të procedurës për shqyrtim të kërkesës 05 Nr.350/02–216060/20 dt.23.11.2020, për caktimin e kushteve ndërtimore, në emër të kërkuarëve/pronarëve, Nazmi Berisha, Hafiz Mehmeti, Qazim Durmishaj, Fatlume Mehmetaj, Islam Nitaj, Muharrem Nitaj, Naim Zeneli, Endrit Pllashniku, Fatmire Pllashniku, Erjona Pllashniku, Ejup Pllashniku nga Prishtina dhe Investitorit “Real Invest” SH.P.K., me adresë në Rr. Lot Vaku, Mat 1, Prishtinë, e përfaqësuar nga z.Florent Blakaj nga Istogu, me aktin administrativ 05 NR.350/02 – 216060/20 DT. 23.07.2021, janë caktuar kushtet ndërtimore nga kjo drejtori.

Paraprakisht janë mbajtur takime me pronarët e parcelave të përfshira në këtë zonë. Takimet janë mbajtur me datë 05.07.2021, në orën 10⁰⁰. h, në zyrat e Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, dhe ftesës i janë përgjigjur përfaqësuesi Avokati Shefqet Hasimi, Labinot Reçica dhe Bujar Jashari si dhe Islam Nitaj dhe Florent Blakaj.

Lidhur me ndërtimin e ndërtesave shumë banesore dhe afariste Lam. A dhe B, për të cilat janë caktuar kushtet ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar sipas Vendimit 05 NR.350/02 – 216060/20 DT. 23.07.2021, në lagjen Mat 1, kjo drejtori ju informon se këto kushte ndërtimore janë lëshuar në harmoni të plotë me të gjitha kriteret dhe parametrat urban të përcaktuara me dokumentet e planifikimit hapësinor-Planin Rregullues Mat 1 dhe PZHU, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe konformë rregullativës ligjore në fuqi.

Edhe pse në shkresat e juaja nuk keni specifikuar saktë qëllimin e ankesës, në rast se ankesa e shprehur është rreth infrastrukturës, kriterëve dhe parametrave të caktuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, duhet ti drejtoni te Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, si organ kompetent për hartimin e tyre.